



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

|            |         |     |  |
|------------|---------|-----|--|
| 12-03-2026 |         |     |  |
| 07-        | 060/07- | 319 |  |



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **II** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **18.03.2026 (e Mërkur)**, në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Konferencave në objektin e vjetër të komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois - Francë

Viti, më 12.03.2026

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL

### NGA MBLEDHJA E PARË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **19.02.2026 (e enjte)**, në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i kuvendit komunal), z.Illir Zuka, z.Basri Aliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, zn.Liridona Bislimi, znj.Elsa Jahija. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se janë prezent të gjithë anëtarët e KPF-së dhe ka kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të rregullt të KPF-së. Pra, materialin e keni marrë me kohë, konfirmimin e ligjshmërisë thuaja se i kemi pranuar për të gjitha vendimet. Ju uroj ditën e parë të Ramazanit. Para se me hy në rend të ditës hapim diskutim.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përshëndetje për të gjithë! Edhe unë shfrytëzoj rastin të ju uroj mandatin e anëtarëve të KPF-së dhe ju uroj fillimin e muajit të shenjtë të Ramazanit. Kryesues, në dakordim edhe me sekretarin e kuvendit, edhe drejtoreshën, sot e kemi një propozim vendim, që në Sllatinë tek oborri i shkollës ta ndajmë një pjesë të parceles për ndërtimin e çerdhes. Propozim vendimin e prezentojmë tani. Kërkoj që të hinë në rend të ditës kjo pikë e rendit të ditës.

**z.Illir Zuka:** Përshëndetje për të gjithë! Ju uroj punë të mbarë! Unë kam me i ngritë dy çështje. E kemi ndriçimin publik në rrugën kryesore në Pozharan, është jashtë funksionit. Kemi provu shumë mënyra për me e rregullu. Po uroj që me ba diçka me e rregullu. Edhe e kemi fillu dikun në muajin shtator një trotuar te rruga "Haxhi Emini", rruga "Sabit Zuka", lagjja Zuka. Dilni këshyrne çka është ka ndodhë me ta. Ato anësore i kanë lëshu, i kanë ngjit nja 100 metra, kanë lujt, kanë dal në asfalt. Është papërgjegjësi totale. Kush është ajo kompani, ama ato po sjellin aksidente, revolt tek qytetarët. Thjesht po bi me një pozitë që mos me i ra fare asaj rruge, se u blloku rruga. Ose merrni hekni krejt ato anësore, e mbushmi me zall siç u kanë, edhe në rregull. Ama në qet gjendje si është, është shumë keq.

**zn.Liridona Bislimi:** Nënkryetar, tek fshati Drobesh, ku është ajo pjesa afër gjamisë, ajo parcela, vitin e kaluar ajo pjesë është shfrytëzu si deponi e mbeturinave, mbeturinave inerte. Kisha pas qef me ditë, me pas informacion për këtë, me ditë ato mbeturina nga kush janë hedh, se janë hedh në orët e vona, edhe nëse keni marr naj vendim, a kanë me u largu ato apo kanë me qenë aty.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Me sa e di unë, ajo pjesë është e AKP-së.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Unë e di që në atë kohë kur është caktu vendi për ndërtimin e xhamisë, kam qenë drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit, dhe e kam bërë atë ndarjen. E di që kjo pjesë që e tha kryesuesi është e AKP-së. Mos ka qenë edhe e pylltarisë, po sakt nuk e di. Do të interesohem për këtë, se e kujt është, kush është tu e shfrytëzu dhe kush e ka bërë. Do të bëjë përpjekje me marr informacione për këtë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për debat, vazhdojmë me këtë:

## Rend dite

1. Pasqyrat financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2025.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2026.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS).
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Vitisë, të cilët do të përfaqësojnë Komunën e Vitisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues për flet dylli dhe koshere blete, projekt i realizuar në vitin 2025, dhe 20% e participimit të fermerëve përfitues në mekanizëm bujqësor dhe serra nga subvencionet për vitin 2026.

E patëm edhe një propozim për pikë të rendit të ditës. A jeni që propozim vendimi për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me Nr.1088-0, me sipërfaqe 17758 m<sup>2</sup> në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla", e cila parcelë do të destinohet për ndërtimin e çerdhes, dhe parcela në të cilën do të ndërtohet çerdhja do të jet Parcela Nr.1088-2 me sipërfaqe 4000 m<sup>2</sup>. A jeni që edhe kjo pikë të hin në rend dite. Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

### 1. Pasqyrat financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2025

**znj.Milohate Ajeti drejtoresh e financave:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Buxheti i aprovuar për vitin 2025 në total për të gjitha kategoritë ekonomike është 19.090.931,87 €. Buxheti i alokuar për periudhën janar – qershor 2025 për të gjitha kategoritë ekonomike është 19.090.931,87€, ndërsa shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike janë 18.883.720,54 €. Shpenzimet për kategorinë paga dhe shtesa janë 10.265.171,89 € apo shprehur në përqindje 99,95% në krahasim me alokimet. Shpenzimet për kategorinë mallra dhe shërbime janë 3.177.362,09 €, apo shprehur në përqindje 98,69% në krahasim me alokimet. Shpenzimet për shërbime komunale janë në përqindje 97,73%. Shpenzimet për subvencione dhe transfere janë përqindje 98,88%. Shpenzimet për investime kapitale janë në përqindje 96,77%. Në pasqyrat financiare keni të prezentuara buxhetin e aprovuar, alokuar dhe shpenzuar për të gjitha programet buxhetore. Zyra e Kryetarit ka shpenzuar në total 99,17%. Administrata dhe Personeli ka shpenzuar 98,92%. Inspeksioni ka shpenzuar 99,74%. Zyra e Kuvendit Komunal ka shpenzuar 99,87%. Buxhet e financa ka shpenzuar 96,45%. Shërbime publike ka shpenzuar 99,40%. Zyra e Komuniteteve ka shpenzuar 100,00%. Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural ka shpenzuar 99,24%. Gjeodezi, kadastr dhe pronë ka shpenzuar 96,89%. Planifikimi urban dhe mjedisi ka shpenzuar 100,00%. Shëndetësia ka shpenzuar 99,58%. Shërbime sociale ka shpenzuar 98,81%. Kulturë, rini dhe sport ka shpenzuar 99,72%. Arsimit dhe shkencë ka shpenzuar 99,98%. Të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar – qershor 2025. Të hyrat e planifikuara për vitin 2025 janë 1.270.127,00€. Të hyrat e realizuara për periudhën janar - dhjetor 2025 janë 1.567.205,84 € apo shprehur në përqindje realizimi, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 123,39%. Krahasimi i të hyrave vetanake për periudhën janar – dhjetor 2025 me të hyrat janar - dhjetor 2024. Të hyrat janar – dhjetor 2025 janë 1.567.205,84 €, ndërsa të hyrat janar - dhjetor 2024 kanë qenë 1.233.358,05 €. Të hyrat e vitit 2025 janë më të larta për 333.847,79 €. Prezentimi analitik i investimeve kapitale për periudhën janar – dhjetor 2025, gjatë kësaj periudhe shpenzimet nga investimet kapitale në total janë 4.301.636,62 €, që i keni të paraqitura në mënyrë të detajuar në raport. Vlen të theksohet se nga shuma totale 2.566.634,22 € janë të ekzekutuara nga Komuna e Vitisë për projektet që kanë punë të kryera në teren, dhe me situatë të pranuar nga organi mbikëqyrës, ndërsa shuma prej 1.735.002,40 € janë shpenzimet të ekzekutuara nga thesari i shtetit, e që këto shpenzime janë obligime të viteve të mëhershme që rrjedhin nga kontrata kolektive. Krahasimin e shpenzimeve për periudhën janar – dhjetor 2025, me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Shpenzimet e vitit 2025 në krahasim me shpenzimet e vitit 2024 janë me të ulta për 892.032,38 €. Dhe në fund keni të prezentuara obligimet dhe të hyrat e bartura

në vitin 2026. Obligimet e bartura nga të gjitha kategoritë ekonomike janë 4.576.563,21 €, ndërsa të hyrat e bartura dhe rritja e të hyrave vetanake që barten për shpenzim në vitin 2026 janë 303.855,75€.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë.

**z.Jakup Demiri:** Tek bartja nga viti në vit, që janë të inkuorporuara në përqindje tek investime kapitale. Këto investime kapitale i kemi dikun 96.77% të realizuara. Sa nga kjo përqindje janë për shpenzime komunale? Sa nga këto janë vendime gjyqësore? Tek buxheti real du me ditë sa fatura kemi me i pagu këtë vit nga mbetjet, obligimet.

**z.Basri Aliu:** Përsëritet të nderuar të pranishëm. Po kërkoj një sqarim. Buxheti i aprovuar është 19.090.931,87 €. Alokimi i buxhetit është 100%, ndërsa shpenzimi është 18.883.720,54 €. Sipas kësaj, buxheti i pashpenzuar është 207 mijë euro, prej nga kanë mbet këto mjete që nuk janë shfrytëzuar.

**z.Illir Zuka:** Drejtoreshë, na e kemi pas fal tatimin, e prej këtij viti do të fillon pagesa. Po ne te tatimi i tokës nuk kemi pas shti. A kemi një shifer të sakt se sa u bë tatimi në tokë, sa janë grumbullu mjete të inkuasura?

**znj. Milihate Ajeti, drejtoreshë e financave:** E kemi pas një takim për këtë çështje, për këto tatime, po neve na u thanë që në fund të muajit mars është sistemi që rregullohet. Pyetjes së Jakupit, tek përmbaruesit. Jakup, deri tani naj kanë marr 1 milion e 735 mijë e 2 euro.

**z.Basri Aliu:** Drejtoreshë, tek komunalitë a nuk ka të bëjë me të hyrat vetanake fare? Derisa ne kemi pas borxhe, dhe kemi mbetë. Po këtu po figuron 6 mijë e 798 euro nuk janë shfrytëzu, kanë shku suficit. Këto kanë mujt me u shfrytëzu, se na e dimë që prej një kategorie tjetër e bartni dhe i shpenzojmë. Për mallra dhe shërbime 42 mijë euro, që kur të figurojnë edhe borxhet, su dashtë me mbetë këtu. Unë nuk po ta la fajin ty, po si drejtori u dash mu shpenzu këto mjete, sepse kemi pas obligime ndaj operatorëve, kështu që, unë për këtë dashta një sqarim: pse kanë mbetë këto?

**znj.Milihate Ajeti, drejtoreshë e financave:** Ka mujt me pas ndonjë gabim. Do ta shoh këtë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit! A jeni që kjo pikë të shkon në kuvend? Kush është pro? Nga të gjithë kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

## **2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2026**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Propozimin e keni marrë me kohë. Orientimisht kështu duhet me ndodhë. Hapi debat për këtë pikë. Nëse nuk ka: a jeni që edhe kjo pikë të shkon në kuvend? Nga të gjithë u miratu për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

## **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Para juve e keni propozim vendimin për formimin e KKSB-së. Ky këshill është obligativ që të formohet, të propozohet nga kryetari. Këtë e rregullon udhëzimi administrativ. Një ndryshim që e kemi paraqit në propozim vendim e kemi tek Pozharani, ku në vend të Bujar Ostrogllavës do të jet Besim Halimi. Këtë e ka propozu Bujari. Materialin e keni marrë me kohë. Për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Tek kryetari i këshillit të prindërve është Muslia. A jeni konsultu me ta apo qysh?

**znj.Arta Ajeti, drejtoreshë:** Ky që është propozu, është i gjimnazit, mirëpo tani kanë mu zgjedh të rite. Ne e kemi lanë Rrahimin, për shkak se është numër i nxënësve më i madh.

**z.Illir Zuka:** Nënkyetar, me na tregu qeto KLSB-jat; qysh funksionojnë, kush i zgjedh, edhe çfarë funksioni kryejnë, edhe a koordinohen ato me këshillat e fshatrave ato? Ose janë ba një grup në kafe e hajt t'i zgjedhmi. Nuk e di qysh funksionojnë: a koordinohen ata me këshillat e fshatrave? Për çka i keni zgjedh këshillat e fshatrave? Nga viti 2013-2014 këta janë të njëjtë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës:** KLSB-të datojnë menjëherë pas luftës. Ato i kanë pas edhe do trajnime, po udhëzimi administrativ thotë se, KLSB-të e themeluara në nivel të komunës duhet me u përfshi në

KKSB, dhe në bazë të udhëzimit, dajmë prej Pozharanit e kanë pru Bujarin. Edhe ne e kemi propozu, po ai ka thanë jo, unë po e qoj Besimin. Nëse ti je i interesum, ti je banor i atij fshati, ngrite këtë në këshill të fshatit.

**znj.Liridona Bislimi:** Sa i përket kësaj pike, tek pika e parë që deshta me u ndërlidh, është se, në mesin e përshkrimit thuhet se, marrë parasysh kriterin e përfaqësimit gjinor, e në mesin e këtyre anëtarëve, vetëm tri janë femna, ose duhet me u rrit numri i grave ose duhet me u ndryshu kjo pjesa që e keni thanë, janë marrë parasysh kriteret e përfaqësimit edhe te këta tre emra që po mungojnë. Përfaqësuesin e bashkësisë islame nuk e kemi: a keni dërgu ju kërkesë që me jav dërgu një emër ata.

**z.Jakup Demiri:** Keve pak interesant, se disa vende i përcakton institucioni. Shembull, sikur te bashkësia islame e disa fshatra, nuk po mujka. Po flas me emër, se nuk kam të keqe asgjë, se nëse nuk paguhet, ai nuk vjen. Janë 4-5 emra këtu që nuk vijnë. Ky KKSBB nuk funksionon, nuk jemi serioz.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Shumë gjëra që po i thuani ju, është realitet, po një çështje nuk po e thuani: a e kemi obligativ ne si ekzekutiv, në bazë të udhëzimit administrativ me formu KKSBB-në? Po. A vijnë a nuk vijnë. Unë kam pas telashe edhe vitin e kalum. Në momentin që u ndërpre çështja pagesës, kemi pas telashe. Unë nuk e kam rregullu çështjen e pagesës. Funksionalitetin e këtij këshilli e ka hup Ligji mbi Pagat dhe Meditje, ku nuk e ka parapa. Nuk ka indikator mas përformaces që nuk ta lyp. A i ke mbajtur mbledhjet e KKSBB-së? E ke obligativ 6 me i mbajtur. Unë zakonisht i kam mbajtur ka 7, prandaj ne nuk mundemi me dalë jashtë atij udhëzimi administrative, dhe për arsye të mos pagesës, kryetarët e këshillave të fshatrave janë mos funksional. Fatlum, është mirë me korigju atë, se ne nuk mundemi me pru femra më shumë se ta lypë pozicioni.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjithë të pranshmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, edhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Vitisë, të cilët do të përfaqësojnë Komunën e Vitisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Në bazë të ligjit, Asociacioni i Komunave të Kosovës e kërkon çdo komunë me i pasë anëtarët e vet. Kryetari shkon direkt. Kanë me mbajtur takime gjatë mandatit, dhe në Viti jemi përcaktu 3 subjektet e mëdha me qu nga një anëtar nga kuvendi. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, dhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e buxhetit të participuar nga fermerët përfitues për flet dylli dhe koshere blete, projekt i realizuar në vitin 2025, dhe 20% e participimit të fermereve përfitues në mekanizëm bujqësorë dhe serra nga subvencionet për vitin 2026**

**z.Naim Pira, drejtori:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ju uroj për marrjen e mandatit të ri. Para jush kemi sjellë këtë propozim vendim. Ju e dini, vazhdimësi i kemi sjellë vendimet të tilla, në mënyrë që të aprovohet buxheti i 20% të participimit të qytetarëve. Këtë vit nga viti i kaluar na kanë mbetur për të mbyll edhe kosheret e bletëve, për shkak se këto kanë ardh, kosheret, dhe fletët e dyllit janë vonu procedurat e prokurimit, dhe nuk kemi mujtë me sjellë në kuvend, për shkak se prej shtatorit nuk kemi mbajtur mbledhje. Participimi i qytetarëve ka mbetur diku në sirtar apo nëpër llogari, që akoma nuk kemi mujtë me ja pagu operatorit, dhe kemi sjellë që të miratohet kësaj here, por unë në konsultim edhe me Ministrinë e Financave, zyrtarin e thesarit, e diskutum çështjen e projekteve që kanë me u realizu për këtë vit, dhe e kam pyetur që, a mundemi në të njëjtën seancë ta mirtojmë edhe 20%, sepse kemi me rregullore. Më tha mundemi, që mos ta bëmë 2 here, dhe në momentin që kryhet procedura, mundemi operatorëve të ja bëjmë pagesën në të njëjtën kohë. Mos të shkojmë që njëherë 20% të mbetet më vonë. D.m.th e kam sjellë me këtë qëllim, dhe kërkoj mirëkuptimin që të kalon te tabela. Është një gabim, se e vërejtja, tani këtu te sasia 25, duhet të jetë 120kg. Dhe në fund te totali i përgjithshëm, nuk është i fermerëve, por totali i përgjithshëm është i fermerëve dhe i komunës. D.m.th këtë ndryshim e rregullojmë.

**znj.Liridona Bislimi:** Nëse mundem me pas unë edhe një here një përshkrim, jemi tu folë për pagesat e vitit

paraprak.

**z.Naim Pira, drejtori:** Është vetëm te kjo kosheret dhe te dylli. Vitin e kalum na kanë mbetë pa u kry, tjerat janë të kryera.

**znj.Liridona Bisilimi:** Meqenëse sektori i bujqësisë është sektori që prek më së shumti komunën tonë, edhe vazhdimisht qytetarët janë jashtëzakonisht të interesuar për subvencione, për mjete, tu e marrë parasysh faktin që, te faqja zyrtare e Komunës së Vitisë, ka disa vite që jam e bllokume, dhe te faqja e kryetarit, te faqja e Komunës së Vitisë, nganjëhere zhblllokohem 2-3 ditë. Nuk e di pse ideja është që nuk mundem me i përcjell aplikimet. D.m.th, kjo që ka qenë për bleta, mua më ka ikur. Nuk e kam ditë, veç kur më kanë pyet qytetarët se, pse, se paraprakisht më kanë thanë me i lajmru, se ka pas të interesum. Tani veç kur e kam parë që ka dalë si aplikim dhe është kry procedura. Unë si shoqnisht, kolegialisht po të kërkoj që, çdo aplikim që bëhet, çdo subvencion, nëse mundesh të paktën në faqen tane zyrtare, në rrjete sociale me shpërnda, aty ku kam qasje.

**z.Naim Pira, drejtori:** Ajo çka është obligative nga ana e drejtorisë, është ta bëjë publike në web faqen e komunës, dhe selien e drejtorisë. Të jesh e bindur që faqe personale nuk kam, faqe të drejtorisë nuk kemi, kanë nejtë të ekspozume, dhe 1 muaj në dritare, aty jashtë në shtëpi të kultures dhe në zyre të Drejtorisë, dhe në web faqe të komunës ka qenë.

**z.Ilir Zuka:** D.m.th, këta i kanë marrë koshered, e këto tash i keni mbetë borxh atij.

**z.Naim Pira, drejtori:** Nuk i kemi mbetë borxh, veç participim të cilin e kanë pagu 20%, nuk kemi mujtë me kalu përmes kuvendit, se prej shtatorit nuk kemi mbajtur mbledhje. Nga subvencionet dhe mjetet e alokume, na kanë marrë diku 78 mijë euro vitin e kalum përmbarusi privat. Ajo është e papranueshme.

**z.Basri Aliu:** Unë pak jam në rrjedh të kësaj ngjarje, sepse më ka ra me ushtru detyrën, nuk ka të bëjë kurgja tjetër, përveç participimi i qytetarëve që është këtu, dhe që duhet mjetet të cilat ata vet kanë pagu me i aprovu ne në kuvend, në mënyrë që të realizohet dhe të shkojnë mjetet operatorit ekonomik.

**z.Naim Pira, drejtori:** Prej 2023 Ministria e Financave thotë: procedurat për menaxhimin e pranimin dhe alokimin e mjeteve për mbështetjet e njëanshme në participim të qytetarëve, d.m.th as nuk është udhëzim administrative, po në kuadër të financave, zyra e thesarit i kish parapa këto procedura.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit! A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, dhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

**6. Propozim vendim për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me Nr.1088-2, me sipërfaqe 17758 m<sup>2</sup>, në pronësi juridike të "D.S Osnava shkolla", e cila parcel do të destinohet për ndërtimin e çerdhes, dhe parcela në të cilën do të ndërtohet çerdhja, do të jetë parcela Nr.1088-2 me sipërfaqe 4000m<sup>2</sup>**

**z.Ilir Zuka:** Drejtoreshë, për këtë ndarje që keni bë, për parcelen për një çerdhe: a ka kërku ministria, ka ndarë ministria për ndonjë çerdhe në Komunën e Vitisë.

**znj.Arta Ajeti, drejtoreshë:** Jo, nuk ka kërku ministria, kërksa është e jona. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Sot para jush kemi një propozim vendim, ku ky propozim vendim e ka për qëllim ndryshimin e destinimit të një pjese të parceles, e cila është në Sllatinën e Epërme, d.m.th shkollën "Njazi Rexhepi", shkolla amë, ku aty kemi sipërfaqe totale, prej 17 mijë e 758 metra katror, ndërsa e cila është me pronësi juridike të shkollës, dhe kjo parcelë propozohet që, 4 mijë metra katror të ju ndahet për një çerdhe të re, të bashkëngjitur. E keni fletën poseduese, kopjen e planit. Ky vendim nuk e cenon interesin publik, përkundrazi i rritë shërbimet për qytetarët, i përgjigjet kërkesave të komunitetit, dhe për këtë arsye kërkoj përkrahjen tuaj për miratimin e këtij propozim vendimit.

**z.Ilir Zuka:** Mendova që ministria e ka parapa. Tani një çerdhe, se ne e dimë që para 4 viteve me urgjencë na ka pas kërku me nda një parcelë për gjykatë dhe për çerdhen, dhe çka ka qenë interesant mas 3 muajve, ajo çerdhe ka shku në Kamenicë, për atë mendova që na ka nda prapë ministria ndonjë çerdhe, se është mirë me pas Sllatinën aty.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Në mbledhje të bordit të cilën e kemi mbajtur, kryetari ka marrë disa vendime. Të gjithë digasteret e Komunës së Vitisë që kanë ministri të lindjes, me u drejtu me kërkesa të

nevojshme që kanë qyteterët e Komunës së Vitisë, sa ato do të aprovohen. Është çështje edhe e buxhetit të cilin e kanë dhe mirëkuptimin që mundet me pas, dhe ndikimi njerëzor që mund me qenë, por megjithatë projektet me u drejtu në atë adresë, megjithatë kërkesa duhet me qenë. Ne duhet me qenë të përgatitur çka ata munden me na dhanë. Në rast se e keni përcjell kryesuesin në komitet me përcjell mbledhjen dhe pasqyrat financiare, mandat më i vështirë, jo që është Sokol Haliti, nuk ka. Ky do të jetë pak dhe I vitit të ardhshëm. 4.5 milion faktura të evidentuara, unë po mundem me supozu që ka dhe pa evidentu dhe shifra kalon në 5 milion, dhe në këtë drejtim dhe kryeministri dhe ministrit kan me pasë mirëkuptimin se qysh I dimë ne pasqyrat financiare ato qdo mengjes I dinë detaj, në rastë se nivel qendror ka me pasë mjete ka me qenë sivjet e mbeshtetjes së komunave më shumë përshtkak se kjo problematic nuk është veq për vitin por I godet komunat që kan mjete më pak.

**z.Basri Aliu:** Si vendim e përkrahim, sespse e di që oborri shkollës ka sipërfaqe të mjaftueshme, por tash është edhe një pyetje, që pasuritë shoqërore janë në kuadër të komunës.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Të komunës nuk ka titular. P.sh.: Agjensioni i Pyjeve apo tjerat komuna drejtpërdrejt është.

**znj.Arta Ajeti, drejtoreshë:** Sa i përket në Sllatinë, te shkolla e vjetër, është propozim, që objekti të jet i ri e mos të shkojmë në adaptim.

**z.Illir Zuka:** Me një fshat në Komunën e Vitisë, një nxënës, e katër arsimtar kanë shku me dhanë mësim, e ai ish kanë i smut e ata kanë nejt. Një nxënëse është me një klasë.

**znj.Arta Ajeti, drejtoreshë:** Ilir, nuk ka një klasë me një nxënëse. Këtë po e qipkni, po me vjen keq. E të puna e Sllatinës. Ne e dimë që si vend frekuentohet shumë, edhe në Ferizaj, sidomos e kemi Budrikën e Radivojcin që frekuentohen në Gjilan. Unë besoj që, me hapjen e kësaj çerdhe në të ardhmen, nashta edhe shumë prindër aty i lënë fëmijët edhe kthehen. Unë e mirëpres shumë këtë çerdhe këtu, po edhe në fshatra tjera.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë të shkon për në kuvend? Me votat e të gjithëve edhe kjo pikë shkon në kuvend.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Bekim Azizi**

---

71ku 2



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

|            |     |      |    |
|------------|-----|------|----|
| 72-03-2026 |     |      |    |
| 02         | 035 | 02-3 | 20 |



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



Në bazë të nenit 11, 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008 dhe neni 13 dhe 8 paragrafi 3, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja l, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës me datën 11.03.2026, bën këtë :

### PROPOZIM VENDIM

#### PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEQANT TË PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHEN PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2026

##### Neni 1

Me këtë propozim – vendim, propozohet të miratohet Lista e veqant e pronave të palujtshme të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026.

##### Neni 2.

Lista sipas nenit 1 të këtij propozim-vendimi për secilen pronë arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës, të dhënat kadastrale, qellimin e dhënjës në shfrytëzim, destinimi i pronës parashikimi.

##### Neni 3

Pjesë përberse e këtij propozim vendimi është Lista e veqant e pronave të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026 përfshirë certifikaten e pronës dhe kopjen e planit.

##### Neni 4

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi dhe procedurat tjera të parapara, me të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës Obligohet Drejtoria e Kadastrit, Pronës dhe Gjeodezisë në bashkpunim dhe kordinim me Drejtorit tjera të Komunës varsisht fushveprimtarisë përkatëse. Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

##### Neni 5.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:  
Sokol Haliti






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Planifikimi i zonave të përdorimit të tokës  
12-03-2026  
02-035/02-321



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



LISTA E VEQANT E PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHET PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM GJAT VITIT 2026.

| Nr | Të dhënat kadastrale të pronës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Arsyetimi i interes publik dhe zhvillimi ekonomik                                                                                                                       | Destinimi                                                               | Periodha kohore për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------|
| 1. | Njesisë kadastrale P-70101023-00991-0 në sipërfaqe prej 33358 m <sup>2</sup> ,<br>Njesisë kadastrale P-70101023-01576-0 në sipërfaqe prej 10553 m <sup>2</sup> ,<br>Njesisë kadastrale P-70101023-01005-0 në sipërfaqe prej 38424 m <sup>2</sup> ,<br>Pjesen prej 100000m <sup>2</sup> të njesisë kadastrale P-70101023-01577-0 në sipërfaqe prej 142999 m <sup>2</sup> në zonën kadastrale në Zhiti | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë. | Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzimin bujqësor | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.     |
| 2. | Njesisë kadastrale me numër:<br>P-70101018-00175-0, në sip. 211198 m <sup>2</sup> ,<br>P-70101018-00197-0, në sip. 96342 m <sup>2</sup> ,<br>P-70101018-00200-0, në sip. 130577 m <sup>2</sup> ,<br>P-70101018-00211-3, në sip. 110000 m <sup>2</sup> ,<br>në zonën kadastrale në Devajë.                                                                                                            | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë. | Pyjore<br>Pyjore<br>Pyjore<br>Bujqësore                                 | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatgjat.         |
| 3. | P-70101038-01724, pjesa prej 18234 m <sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 27665 m <sup>2</sup> , në vendin e quajtur "Rashiq në zonën kadastrale në Smirë.                                                                                                                                                                                                                                | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për bujqësor a të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë                  | Pyjore                                                                  | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter      |
| 4. | Pjesën prej 300m <sup>2</sup> të njesisë kadastrale P-70101005-00630-0, nga sipërfaqe e përgjithshme prej 13282m <sup>2</sup> , Toka bujqësore , kullosë e klasit të 5, në vendin e quajtur " Zabel" në zonën kadastrale në Terpezë                                                                                                                                                                  | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës.                                                                            | Bujqësore                                                               | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.     |
| 5. | Njesisë kadastrale P-70101021-00470-0 në sipërfaqe prej 4740 m <sup>2</sup> , Toka bujqësore në vendin e quajtur "Rosulja Kod G Drobesha"                                                                                                                                                                                                                                                            | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e të hyrave.                                                                                           | Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për tregun e kafshëve     | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.     |

|    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                         |                  |                                                               |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|---------------------------------------------------------------|
| 6  | Njesisë kadastrale P-70101040-01784-1 në sipërfaqe prej 37151 m <sup>2</sup> , Toka pyjore në vendin e quajtur "Zhar zhar"<br>Njësia kadastrale P-70101040-01785-0 në sipërfaqe prej 3968 m <sup>2</sup> , në zonën kadastrale në Sadovinë e Çerkezëve                                                                                                                                                                     | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë. | Zona industriale | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter. |
| 7. | Njesisë kadastrale P-70101003-01840-0 në sipërfaqe prej 8900 m <sup>2</sup> , Toka bujqësore në vendin e quajtur "Meçevac"<br>Njesisë kadastrale P-70101003-01846-0 në sipërfaqe prej 14910 m <sup>2</sup> , Toka bujqësore në vendin e quajtur "Meçevac",<br>Njesisë kadastrale P-70101003-01607-2 në sipërfaqe prej 32552 m <sup>2</sup> , Toka jo pjellore në vendin e quajtur "Malishte", në zonën kadastrale në Binçë | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë. | Pyjore           | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatgjatë     |
| 8. | Njesisë kadastrale P-70101037-01813-0 në sipërfaqe prej 1737 m <sup>2</sup> , Toka bujqësore në vendin e quajtur "Sllanishte" dhe<br>Njesisë kadastrale P-70101037-01790-0 në sipërfaqe prej 3791 m <sup>2</sup> , Toka bujqësore në vendin e quajtur "Sllanishte" në zonën kadastrale në Sllatinë.                                                                                                                        | Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë  | Bujqësore        | Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter. |

Me datën 10.03.2026, Viti.

Kryetari i Komunës:  
Sokol Haliti





## Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /

Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

## EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

### PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Vitisë

|                                                                                            |                      |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:                                      | 176/2026             |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:          | 11.03.2026 - 08:28   |
| Komuna / Opština / Municipality:                                                           | VITI / VITINA / VITI |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | VITI / VITINA / VITI |

### A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit)<br>Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa)<br>Last Name / Business Name | Emri<br>Ime<br>First Name | Emri i babait<br>Ime oca<br>Father's Name | Gjinia<br>Pol<br>Gender | Nr. personal/ biznesit<br>Lični broj/broj<br>poslovanja<br>ID. No. | Shreti i shtetësisë apo<br>regjistrimit Država<br>državljanstva ili uknjiženja<br>Country of citizenship | Dirëlidhja/Data e<br>themelimit<br>Rodendan/Dan<br>osnivanja<br>Date of<br>Birth/Establishment | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|-------------------------------------------|-------------------------|--------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|----------------------------------|
| Komuna e Vitisë                                                                                         |                           |                                           | /                       | 600424486                                                          | KOSOVA /<br>KOSOVA /<br>KOSOVO                                                                           |                                                                                                | 29.12.2020                                        |                                  |

### A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

